



Planuar - Planirano 22-07-2020
 Nr. i organit Org. broj 02-370/03-666
 Numri/Ido
 Shtetës Prillog
 Vlera Wednos

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Komuna e Vitisë Opština Vitina-Municipality of Vitina</p>	
---	---	---

ZYRA E PROKURIMIT

KONTRATË PËR FURNIZIM

Nr. prokurimit	VI657	20	2355	1-3-6
Nr. brendshëm	VI657	20	030	136

TITULLI I KONTRATËS : **Furnizim me material për stomatologji**

E LIDHUR NË MES TË

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
Grup i Operatorëve Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K.; Adnan A. Bala B.I., Ferizaj, Përfaqësuar nga:	KOMUNA E VITISË Përfaqësuar nga:
Adnan Bala, me autozim 	Fadil ABAZI, menaxher i prokurimit 

Titulli: Furnizim me material për stomatologji; Nr. Prokurimit: VI657-20-030-136

PJESA B: KONTRATA

KOMUNA E VITISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K.; Adnan A. Bala B.I., Ferizaj,
(në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizim me material për stomatologji me numër Identifikues *VI657-20-2355-1-3-6*

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë ***Furnizim me material për stomatologji***

1.2 Kontrata hynë në fuqi ditën e nënshkrimit. Kontrata fillon së implementuari nga dita nënshkrimit 20.07.2020 dhe përfundon me 19.07.2021, që nënkupton se kontrata është njëvjeqare.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i Komuna e Vitisë, do të jetë te gjitha njesite shpenzuese.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-063 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4,522.00 €;**

Me fjalë: **Katër mijë e pesë qind njëzet e dy Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

[Kontrata perbehet me **shume** dërgesa]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimi të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

E hartuar në gjuhën *Shqip*² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Ofruesin e furnizimeve		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Adnan Bala	Emri:	Fadil ABAZI
Pozita:	Me autorizim	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	20/07/2020
Vula:		Vula:	

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimi të *[furnizimeve]*

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 30 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata themelore Gjilan-dega ne Viti* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>gjuha Shqipe</i>
	2.4	Liferimi i mallrave të kryhet brenda 48 orë më së largu nga porosia ose leshimi Urdherblerjes
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<i>Menaxher i kontratës Adnan Neziri</i>
Pagesa	20.1	<i>Pagesat për furnizimin e kryer do të bëhen sipas faturave të furnizimit dhe urdhër blerjeve</i>
Dorëzimi	21.3	Sipas kërkesave të njesive shpenzuese, në lokacionet ku ato gjenden..
<i>Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes</i>	31.2	Palet do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin në mes tyre sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje , palet do të lajmrojnë njëra-tjetren me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme
<i>Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore</i>	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]. Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike



Komuna e Vitise
Municipality of Viti
Opstina Vitina



Qendra kryesore e Mjekesise Familjare
„Nëna Tereze“ Viti

Paramasa per Furnizim me material Stomatologjik		2020			
Nr	Emertimi	Njesija	sasija	Çmimi	Totali
1	Lidokainë amp 2% me adrenalinë 2x100	Pako	15	20.00 €	300.00 €
2	Amalgam I 1x50	Pako	10	1.50 €	15.00 €
3	Amalgam II 1x50	Pako	10	30.00 €	300.00 €
4	Helio A1	Cope	10	10.00 €	100.00 €
5	Helio A2	Cope	10	12.00 €	120.00 €
6	Helio A3	Cope	10	2.00 €	20.00 €
7	Helio B1	Cope	10	2.00 €	20.00 €
8	Helio B2	Cope	10	2.00 €	20.00 €
9	Primer bond	Cope	15	8.50 €	127.50 €
10	Brusha për bond	Cope	5	2.50 €	12.50 €
11	Freza të diamantit	Cope	300	0.70 €	210.00 €
12	Freza të qelikut për kunderkand	Cope	300	0.40 €	120.00 €
13	Fosfat cement për shtresë	Cope	10	9.00 €	90.00 €
14	Letër artikuloese	Pako	10	5.00 €	50.00 €
15	Letër celuloide	Pako	10	1.00 €	10.00 €
16	Shkopinjë gutaperka 20	Pako	10	0.80 €	8.00 €
17	Shkopinjë gutaperka 25	Pako	10	0.80 €	8.00 €
18	Shkopinjë gutaperka 30	Pako	10	0.80 €	8.00 €
19	Shkopinjë gutaperka 35	Pako	10	0.80 €	8.00 €
20	Shkopinjë gutaperka 40	Pako	10	1.20 €	12.00 €
21	Shkopinjë gutaperka 15-40	Pako	10	4.00 €	40.00 €
22	Paper point 20	Pako	10	0.50 €	5.00 €
23	Paper point 25	Pako	10	0.80 €	8.00 €
24	Paper point 30	Pako	10	0.50 €	5.00 €
25	Paper point 35	Pako	10	0.50 €	5.00 €
26	Paper point 40	Pako	10	0.80 €	8.00 €
27	Paper point 15-40	Pako	10	3.70 €	37.00 €
28	Lidokainë spray 10% Flakon	Cope	30	9.00 €	270.00 €
29	Freza për proteza	Cope	20	0.10 €	2.00 €
30	Brusha për pastrimin e instrumenteve	Cope	10	2.50 €	25.00 €
31	Acid	Cope	15	3.00 €	45.00 €
32	Dezinfektues për instrumente 700ml	Liter	15	9.00 €	135.00 €
33	Chlumsky	Cope	15	5.00 €	75.00 €
34	Vaj turbine	ml	20	10.00 €	200.00 €
35	Aspirator plastik	Pako	10	2.00 €	20.00 €

36	Përparëse (kompresa)	Rollne	20	4.00 €	80.00 €
37	Asepsol 5%	Liter	15	5.50 €	82.50 €
38	Gjilpëra Lentulla 25	Pako	30	0.40 €	12.00 €
39	Gjilpëra Lentulla 30	Pako	30	0.50 €	15.00 €
40	Gjilpëra Lentulla 35	Pako	30	0.50 €	15.00 €
41	Lentulla 25-40	Pako	15	5.00 €	75.00 €
42	Zgjerues kanait 15-40	Pako	15	4.00 €	60.00 €
43	Zgjerues 20	Pako	15	0.25 €	3.75 €
44	Zgjerues 25	Pako	15	0.25 €	3.75 €
45	Zgjerues 30	Pako	15	0.25 €	3.75 €
46	Zgjerues 35	Pako	15	0.25 €	3.75 €
47	Zgjerues 40	Pako	15	0.30 €	4.50 €
48	Zgjerues të kanalit Titanium	Pako	15	0.70 €	10.50 €
49	Vaterollna të letrës	kg	20	8.00 €	160.00 €
50	Pastë për devitalizim (pa arsenik)	Cope	15	15.00 €	225.00 €
51	Jodoform pluhurë	Cope	10	7.00 €	70.00 €
52	Mbushje devinitive të kanaleve	Pako	10	24.00 €	240.00 €
53	Hemostatik për ndaljen e gjakderdhjes	Pako	15	5.00 €	75.00 €
54	Mbushje të përkohshme të kavitetit	Cope	15	4.00 €	60.00 €
55	Zinc Oxyde L+P	Pako	10	9.00 €	90.00 €
56	Goma për polirimin e mbushjeve	Cope	50	0.50 €	25.00 €
57	Calcium Hydroxid me Jodoform	Cope	10	14.00 €	140.00 €
58	Calcium Hydroxid pa Jodoform	Cope	10	1.20 €	12.00 €
59	Calcium Hydroxid 2 komponentë	Pako	10	13.00 €	130.00 €
60	Maska me llastik 1x50 Kuti	Pako	46	4.00 €	184.00 €
61	Matrixa harkore	Pako	10	3.50 €	35.00 €
62	Matrixa shiritw	Pako	10	5.00 €	50.00 €
63	Mbajtës të matricave harkore	Cope	5	1.00 €	5.00 €
64	Mbajtës të matricave shiritë	Cope	5	1.00 €	5.00 €
65	Kurora Celuloide	Pako	5	0.50 €	2.50 €
66	Alveogyl	Cope	5	15.00 €	75.00 €
67	Skalper lekron	Pako	10	0.10 €	1.00 €
68	Trakë abraziv	Pako	10	4.50 €	45.00 €
69	Gota per hidrogjen dhe alkool	Cope	10	0.10 €	1.00 €
70	Kuja parapulpar	Pako	18	4.50 €	81.00 €
71	Kuja pulpar	Pako	20	0.10 €	2.00 €
	Totali				4,522.00 €

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	PRO MEDICAL
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	ZYRAFETE HASHANI
NËNSHKRIMI:	<i>[Signature]</i>
DATA:	03.06.2020
VULA:	

1. *V. Dely*
2. *[Signature]*
3. *[Signature]*



Pranuar - Prilijeno Më/Datë: 22-07-2020
Nr./i organit: 02-370/01-665
Org. broj: Numri/Šroi: Shënimi: Vlera
Vrednos'

	Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Komuna e Vitisë Opština Vitina-Municipality of Vitina	
ZYRA E KRYETARIT KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE		

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008) dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 02 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT PËR MBIKËQYRJEN E FURNIZIMEVE SIPAS
KONTRATËS: **Furnizim me material stomatologjik**

I.

Adnan Neziri, CAKTOHET menaxher i projektit për kontratës: **Furnizim me material stomatologjik .VI657-20-030-136**

I

Menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë:

- Menaxhimin e furnizimit të AK, të menaxhoj obligimet e AK sipas kontratës dhe të siguroj se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar,
- Të siguroj kontroll të kostove, cilësisë dhe sasisë dhe kohën e dërgesave (vonesave),
- Të siguroj arttijen e qëllimit të kontratës, fushëveprimit, spicifikacionit dhe përgjegjësit e AK dhe Furnizuesit.
- Të dorëzoj Planin e menaxhimit të kontratës dhe monitoron kontratën nga nënshkrimi deri në skadimin e saj.
- Të monitoroj/pranoj furnizimet dhe pagesat e kryera nga kompania

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Menaxherit,
2. Operatorit,
3. Zyrës së Prokurimit,
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol HALITI

